



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2022:112283

Datë: 28.06.2022

Numri i dokumentit: 03179976

P.nr.101/2022

NË EMËR TË POPULLIT

- GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Fatos Sejdijaj dhe procesmbajtësen Florije Gucati, duke vendosur në çështjen penale ndaj të akuzuarit S., S., nga fsh...-Komuna Skenderaj, për shkak të veprës penale-Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 lidhur me par.6 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.06/L-074 (tutje:KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm PP-II.nr.883/2022, të datës 11.05.2022 (2022:0031124) duke vendosur lidhur me kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, me datën 28.06.2022, mori këtë :

A K T G J Y K I M

- PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm PP-II.nr.883/2022, të datës 11.05.2022 dhe gjykata e jepë këtë :

U R D H Ë R N D Ë S H K I M O R

- I akuzuari S., S., nga babai ... i lindur me datë ... në fshatin ...-Komuna Skenderaj, ku edhe tani jeton, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal

- Ë S H T Ë F A J T O R -

- SEPSE : Nga koha e papërcaktuar e deri me datë 11.01.2022, i vetëdijshtëm për veprën e tij dhe pasojat e së njëjtës, në shtëpinë e tij në fshatin ..., Komuna Skenderaj, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshme, pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar nga ku është furnizuar me energji elektrike, në mënyrë të paautorizuar është kyçur drejtpërdrejtë në rrjetin elektrik, ashtu që ka larguar hyrjet dhe daljet nga njehsori pastaj ka bërë bashkimin përçuesve drejtpërdrejtë në rrjetin elektrik, duke anashkaluar instrumentin e matjes së shpenzimit, duke furnizuar amvisërinë me energji elektrike pa kontroll të shpenzimit, me ç'rast ka shkaktuar dëm K..it, në shumën prej 379,21 Euro.

- Me këtë ka kryer veprën penale-Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 lidhur me par.6 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

- Andaj, gjykata në bazë të kësaj dispozite ligjore e lidhur me nenet : 4, 38, 43 dhe 69 të KPRK-së, si dhe neni 365, 450 par.1 dhe par.2 nënpar.2.6, neni 453 par.1, neni 463 par.1 dhe 2, neni 495 par.1 dhe 2 të KPP-së, të akuzuarit i shqipton :

- D Ë N I M M E G J O B Ë -

I.- Në lartësi prej dyqind e pesëdhjetë (250.00) Euro të cilën shumë është i obliguar që ta paguajë në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II.- Nëse i akuzuari dënimin e shqiptuar me gjobë nuk e paguan në afatin e përcaktuar nga gjykata, atëherë dënimin e shqiptuar me gjobë në bazë të neni 43 par.3 të KPRK-së do ta zëvendësojë me dënim me burgim, ashtu që një (1) ditë burgim do të llogaritet me njëzetë (20.00) Euro gjobë.

III.- Obligohet i akuzuari që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej njëzetë (20.00) Euro si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumë prej tridhjetë (30.00) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

IV.- Pala e dëmtuar K. K.. për D. dhe F. me E. E. Sh.a-K., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregulltë civil.

A r s y e t i m

- Prokuroria Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm në këtë gjykatë me datë 01.06.2022 ka paraqitur aktakuzën e saj PP-II.nr.883/2022 të datës 11.05.2022, kundër të akuzuarit S., S., nga fsh...-Komuna Skenderaj, për shkak të veprës penale-Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 lidhur me par.6 të KPRK-së dhe në bazë të neni 493 par.1 dhe 2 të KPP-së, ka kërkuar nga gjykata që të akuzuarit t'i shqiptoj urdhrin ndëshkimor-dënim me gjobë pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor, me arsyetimin se janë siguruar prova të besueshme se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

- Gjkata me rastin e shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për dhënien e urdhrin ndëshkimor në kuptim të neni 495 të KPPK-së.

- Gjkata vlerësoi se në shkresat e lëndës ekzistojnë prova të besueshme për dhënien e urdhrin ndëshkimor të cilat e vërtetojnë faktin se i akuzuari ka kryer veprën penale në fjalë si : Kallëzimi penal i Kompanisë Kosovare për Distributum dhe Furnizim me Energji Elektrike-K.. Nr.... i datës ..., Procesverbali i K...it Nr.2011435 i datës 11.01.2022, Fatura e KEDS-it DMIHP 2218420 i datës 21.01.2022, Kalkulimi RH Nr.398776 i datës 21.01.2022 si

dhe foto dokumentacioni dhe shkresat e tjera të lëndës, gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

- Gjykata duke u bazuar në këto prova të besueshme vërtetoi se me veprimet inkriminuese të të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet e veprës penale-**Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 lidhur me par.6 të KPRK-së**, për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penalo-juridik është përgjegjës dhe i shqiptojë dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

- Gjykata në përputhje me nenin 69 të KPRK-së, me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit me gjobë, vlerësoi të gjitha rrethanat në matjen e dënimit, ashtu që Gjykata është e bindur se dënimi i shqiptuar është në proporcion me peshën e veprës penale, përgjegjësinë penale dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, duke vlerësuar se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit, i cili parashihet me nenin 38 të KPRK-së, pasi që një nga qëllimet e dënimit është të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, duke vlerësuar se i akuzuari do të përmbahet nga veprime të paligjshme në të ardhmen.

- Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, gjykata e mori duke u bazuar në nenet 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 dhe nenin 453 par. 1 të KPP-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit u morë në bazë të nenit 39 par.3 pika 3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

- Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë konform nenit 463 par.1 dhe 2 të KPP-së.

- Nga sa u tha më lartë e në kuptim të nenit 365 dhe nenit 495 të KPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË SKENDERAJ

- Departamenti i Përgjithshëm -

P.nr.101/2022 me datë 28.06.2022.

**Procesmbajtësja,
Florije Gucati**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,
Fatos Sejdijaj**

- **KËSHILLË JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. Kundërshtimi i drejtohet kësaj Gjykate me shkrim apo me gojë në procesverbal të kësaj gjykate. Nëse i akuzuari në afatin prej 8 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nuk ushtron kundërshtim, ky aktgjykim do të merr formën e prerë dhe do të ekzekutohet.